

U D H Ë Z I M
Nr.1, datë 19.5.2003

MBI LICENCIMIN DHE KONTROLLIN E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË TURISTIKE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, me ndryshimet përkatëse dhe të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.89, datë 1.3.1993 “Për dhënien e licencave për ushtrimin e veprimtarisë turistike” dhe nr.518, datë 12.8.1996, pika 3 “Për kategorizimin, regjistrimin dhe klasifikimin e njësive akomoduese”,

U D H Ë Z O J M Ë :

1. Organet tatimore nuk do të regjistrojnë dhe nuk do të lejojnë asnjë subjekt të njohur me vendim gjykate si person juridik ose fizik për ushtrim veprimtarie turistike si “agjenci turistike udhëtimi”, “veprimtari turistike akomoduese” (hoteliere) dhe “transport turistik për udhëtarë”, nëse ai nuk është i pajisur paraprakisht me licencën përkatëse të lëshuar nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

2. Subjektet e lartpërmendura, të palicencuara, por të regjistruara në organet tatimore përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, janë të detyruara të paraqesin në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit kërkesën e tyre për pajisje me licencë, brenda 90 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

3. Drejtoria, e cila mbulon veprimtarinë turistike në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, të vërë në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatim-Taksave:

a) listën e subjekteve të licencuara prej Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për ushtrimin e veprimtarisë turistike përkatëse;

b) listën e subjekteve të evidentuara dhe të identifikuara me ushtrim veprimtarie turistike, por të palicencuara prej Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit;

c) listën e njësive akomoduese turistike të paregjistruara në regjistrin e njësive akomoduese turistike në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe të papajisura me certifikatën e klasifikimit të njësive akomoduese turistike, të lëshuar prej saj.

4. Drejtoria, e cila mbulon veprimtarinë turistike në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, të përditësojë rregullisht listat e mësipërme dhe, çdo 3 muaj, t’ia dërgojë ato, me sqarimet e nevojshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatim-Taksave.

5. Drejtoria, e cila mbulon veprimtarinë turistike në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave të bashkëpunojnë për informimin e subjekteve mbi detyrimin e tyre ligjor për licencimin e ushtrimit të veprimtarisë turistike, si dhe për rritjen e shkallës së njohjes prej tyre të akteve normative dhe rregulloreve përkatëse në fuqi, nëpërmjet mediave dhe aktiviteteve të përbashkëta të organizuara në bashki ose qarqe me zhvillim turistik.

6. Drejtoria, e cila mbulon veprimtarinë turistike në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave (nëpërmjet strukturave të policisë tatimore) të bashkëpunojnë për të zbatuar, ndaj subjekteve me ushtrim veprimtarie turistike të papajisur me licencën përkatëse të lëshuar prej Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij udhëzimi, sanksionet administrative sipas dispozitave në fuqi, deri në ndërprerjen ose mbylljen e ushtrimit të veprimtarisë së tyre turistike.

7. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave dhe drejtoria, e cila mbulon veprimtarinë turistike në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
BESNIK DERVISHI

MINISTRI
KASTRIOT ISLAMI